

VENDIM
Nr.715, datë 23.6.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.402, DATË 21.6.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPALLJEN E EKOSISTEMIT NATYROR TË MALIT TË DAJTIT
“PARK KOMBËTAR” (ME SIPËRFAQE TË ZGJERUAR)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pakësimin e sipërfaqes, 167.29 (njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë presje njëzet e nëntë) ha, të Parkut Kombëtar të malit të Dajtit, sipas objekteve të mëposhtme:
 - a) Objekti “Mali i Shpozës” me sipërfaqe 80,53 (tetëdhjetë presje pesëdhjetë e tre) ha dhe me koordinatat përkatëse;
 - b) Objekti “Mali i Mollës”, me sipërfaqe 86,76 (tetëdhjetë e gjashtë presje shtatëdhjetë e gjashtë) ha dhe me koordinatat përkatëse, sipas tabelave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
 2. Ngarkohen Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Tabela

- a) Objekti “Mali i Shpozës” me sipërfaqe 80,53 ha dhe me koordinata:

Nr.	Koordinatat (Sistemi Gauss Krueger S-42, Albania, Zona 4)	
	Lindje (m)	Veri (m)
1.	44 07 890	45 80 040
2.	44 08 900	45 79 710
3.	44 08 800	45 79 100
4.	44 08 220	45 78 780
5.	44 07 500	45 78 820

- b) Objekti “Mali i Mollës”, me sipërfaqe 86,76 ha dhe me koordinata:

Nr.	Koordinatat (Sistemi Gauss Krueger S-42, Albania, Zona 4)	
	Lindje (m)	Veri (m)
1.	44 09 450	45 78 596
2.	44 09 850	45 77 835
3.	44 10 510	45 77 340
4.	44 09 450	45 77 120
5.	44 09 210	45 78 510